



VENDIM

Nr. 118, Datë 18.10.2013

**PËR
EMËRIMIN E ADMINISTRATORIT TË PËRKOHSHËM TË
SHOQËRISË CEZ SHPËRNDARJE SH.A**

Në mbështetje të neneve 8; 9 dhe 18 pika 4, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-S nr. 4, datë 21 Janar 2013 “Për heqjen e licencave të shoqërisë CEZ Shpërndarje SH.A, për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 08, datë 25.01.2008, të ndryshuar, dhe për aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike” të miratuar me Vendimet e Bordit të Komisionerëve nr. 09, datë 25.01.2008, të ndryshuar”; Vendimit nr. 5, datë 21.01.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për vendosjen e shoqërisë CEZ Shpërndarje SH.A në administrim të përkohshëm dhe emërimin e administratorit të shoqërisë CEZ Shpërndarje SH.A, në zbatim të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 4, date 21 janar 2013, “Për heqjen e licencave për aktivitetin e shpërndarjes të energjisë elektrike dhe aktivitetit të furnizimit publik me pakice të energjisë elektrike të shoqërisë CEZ Shpërndarje SH.A; neneve 7 dhe 9 të Rregullores “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, miratuar me Vendimin nr. 1, date 10.01.2012, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 117, datë 08.10.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes dhe emërimit të administratorit të përkohshëm të shoqërisë CEZ Shpërndarje SH.A, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.10.2013, mbasi shqyrtoi aplikimet e kandidatëve për administrator të përkohshëm të shoqërisë CEZ Shpërndarje SH.A,

Vendosi :

1. Emërimin e Z. Arben Seferi, si administrator i përkohshëm i shoqërisë CEZ Shpërndarje SH.A, që të operojë dhe mirëmbajë pajisjet, pasuritë dhe mjetet monetare dhe llogaritë bankare të shoqërisë;

2. Të gjitha funksionet dhe kompetencat e administrimit të shoqërisë CEZ Shpërndarje SH.A, i kalojnë administratorit të emëruar nga ana e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
3. Administratori i emëruar sipas pikës 1 të këtij Vendimi, në administrimin e përditshëm të shoqërisë do zbatojë Rregulloren “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij, në zbatim të nenit 18, pika 4/c të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.
4. Administratori i emëruar sipas pikës 1 të këtij Vendimi, nuk mund të transferojë asnjë aset ose pasuri materiale të shoqërisë CEZ Shpërndarje SH.A, nëpërmjet shitjes, pengut, qerases, shkëmbimit apo formave të tjera.
5. Depozitimi dhe publikimi i këtij Vendim në të dhënat e shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a, me numër NIPIT, K72410014H, do të realizohet sipas autorizimit bashkëlidhur këtij vendim.
6. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë menjëherë administratorin e emëruar sipas pikës 1 të këtij Vendimi, shoqërinë CEZ Shpërndarje sh.a, QKR dhe çdo subjekt tjetër të interesuar, për zbatimin e këtij Vendimi të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI i ERE-s

Petrit AHMETI